Plakja demografike dhe dhimbja kronike në Kosovë: nevoja për kompetenca infermierore dhe ruajtjen e pavarësisë funksionale

Autorët: Agron Bytyqi[1],[2], Prof. Asoc. Dr. Zamira Imeraj[2]

[1] Shoqata për të Drejtat e Pacientëve në Kosovë (PRAK), Kosovë

[2] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Hyrje: Plakja demografike dhe emigrimi po ndryshojnë nevojat për kujdes shëndetësor në Kosovë. Dhimbja kronike, shpesh e ndërthurur me sëmundje të tjera kronike, mund të kufizojë aktivitetet e përditshme jetësore (AVJ), pavarësinë funksionale dhe mirëqenien fizike, psikologjike e sociale. Qëllimi është të analizohen ndryshimet demografike dhe evidenca shkencore mbi ndikimin funksional të dhimbjes kronike, duke identifikuar implikimet për zhvillimin e kompetencave infermierore në kujdesin parësor.

Metodat: Analizë përshkruese e të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga regjistrimet e popullsisë 2011 dhe 2024 dhe statistikat e migrimit për vitin 2024, e ndërthurur me shqyrtim narrativ të literaturës vendore dhe ndërkombëtare mbi dhimbjen kronike, funksionimin, kujdesin e integruar dhe edukimin infermieror. U konsideruan gjithashtu studime vendore mbi vlerësimin e dhimbjes dhe përvojën e pacientëve në shërbimet shëndetësore.

Rezultatet: Mosha mesatare e popullsisë u rrit nga 29.97 vjeç në vitin 2011 në 34.84 vjeç në vitin 2024, ndërsa pjesëmarrja e personave 65 vjeç e lart u rrit nga rreth 7% në 11%. Në vitin 2024, emigrimi përfshiu 37,451 banorë dhe bilanci i migrimit ndërkombëtar ishte −28,413. Evidenca ndërkombëtare thekson se dhimbja kronike mund të kufizojë lëvizshmërinë, vetëkujdesin, gjumin dhe pjesëmarrjen sociale. Studimet vendore identifikojnë mospërputhje në vlerësimin e dhimbjes postoperative dhe pengesa në vazhdimësinë e kujdesit parësor, duke sugjeruar nevojën për forcimin e vlerësimit infermieror dhe kujdesit të orientuar drejt funksionimit.

Përfundime: Ndryshimet demografike theksojnë rëndësinë e forcimit të kujdesit parësor infermieror për pacientët me dhimbje kronike. Vlerësimi i standardizuar i dhimbjes dhe AVJ, edukimi për vetëmenaxhim dhe monitorimi i vazhdueshëm përbëjnë kompetenca prioritare. Nevojiten studime ndërhyrëse të mirëstrukturuara për të vlerësuar efektivitetin e programeve të trajnimit infermieror në përmirësimin e njohurive dhe praktikave profesionale, si dhe ndikimin e mundshëm në funksionimin, pavarësinë dhe cilësinë e jetës së pacientëve me dhimbje kronike.

Fjalët kyçe: Plakja demografike; dhimbja kronike; kujdesi infermieror; aktivitetet e përditshme jetësore; kujdesi parësor.